



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

MIRATOHET

KRYETARI

Ilir META

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR
TË UJIT (ERRU) PËR VITIN 2013**

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

- Duke njohur rolin e Entit Rregullator të Ujit në krijimin e një sektori ujësjellës-kanalizimesh financiarisht të qëndrueshëm, që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshëm për të gjithë konsumatorët;

- Duke e konsideruar shumë të rëndësishme mbrojtjen e konsumatorit në drejtim të cilësisë më të mirë të shërbimeve të ofruara nga operatorët në sektor;

- Duke e konsideruar të rëndësishëm vënien në funksionim të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe rehabilitimin e kolektorëve të largimit të ujërave të ndotura në drejtim të përmirësimit të këtij shërbimi dhe që ka ndikuar edhe në rritjen e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes;

- Duke njohur faktin që operatorët që operojnë në këtë sektor janë kryesisht shoqëri aksionare me pronar njësitë e qeverisjes vendore;

- Duke pasur parasysh problematikat e shumta të hasura nga operatorët gjatë procesit të aplikimeve për pajisje me licencë;

- Duke pasur parasysh që shlyerja e pagesës rregullatore nga operatorët vazhdon të mbetet në një nivel të ulët, duke ndikuar në ushtrimin e aktivitetit të ERRU-së;

- Duke njohur ERRU-në si autoritetin që miraton tarifatat e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, bazuar në përballueshmërinë e këtyre pagesave nga ana e kosumatorëve;

- Duke konsideruar si shumë të domosdoshme kryerjen e investimeve nga operatorët për përmirësimin e shërbimeve që ata ofrojnë dhe duke qenë të vetëdijshëm për ndikimin e këtyre investimeve në rritjen e tarifave për këto shërbime;

Kostaton se Enti Rregullator i Ujit në vitin 2013:

- Ka miratuar licencën e re dhe kushtet e saj, të cilat janë të detyrueshme për operatorët.

- Ka miratuar metodologjinë për vendosjen e tarifave, e cila krijon një lidhje të drejtpërdrejtë tarifë-performancë, duke ndikuar në rritjen e efikasitetit të ofrimit të shërbimeve në sektor.

- Ka sanksionuar për operatorët, që aplikojnë për rritje çmimi, detyrimin për zhvillimin e seancave dëgjimore me publikun;

- Ka përzgjedhur 10 treguesit kryesorë të performancës për të vlerësuar performancën e operatorëve, me qëllim që këta të fundit të angazhohen në ofrimin e shërbimeve më efikente e më cilësore.

- Ka miratuar instrumentin e Bilancit të Ujit, një instrument që, përveç operatorëve, u shërben edhe ERRU-së dhe njësive të qeverisjes vendore për monitorimin e performancës së operatorëve, në lidhje me cilësinë e shërbimit.

- Ka publikuar dy raporte të performancës së operatorëve ujësjellës-kanalizime në sektor, ku shqyrtohet performanca individuale e operatorëve, krahasuar me atë të operatorëve të tjerë.

- Ka kryer inspektime në lidhje me verifikimin dhe saktësimin e të dhënave të operatorëve, që lidhen me treguesit kryesorë të performancës.

Kërkon nga Enti Rregullator i Ujit për vitin 2014:

- Të angazhohet në forcimin e pavarësisë institucionale dhe në ushtrimin e veprimtarisë së tij në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese;

- Të angazhohet në forcimin e kapaciteteve të tij administrative;

- Të jetë i vëmendshëm në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, për sa i përket cilësisë së shërbimeve të ofruara nga operatorët në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura;

- Të ketë parasysh gjetjen e balancës mes mbrojtjes së konsumatorit dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit, gjatë procesit të vendosjes së tarifave;

- Të vazhdojë të monitorojë performancën dhe ecurinë e shërbimit të operatorëve ujësjellës-kanalizime, në drejtim të përmbushjes së detyrimeve të tyre ndaj konsumatorit dhe t'i orientojë ata drejt efikasitetit të energjisë, e cila ka ndikim të madh në strukturën e kostos;

- Të angazhohet në një rregullim sa më të mirë të sektorit dhe përditësimin e standardeve të shërbimit në këtë sektor;

- Të vazhdojë të monitorojë të dhënat dhe zbatimin e tarifave të miratuara, si dhe Bilancin e Ujit për operatorët e ujësjellësve;

- Të vazhdojë të angazhohet në zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, pavarësisht mungesave të legjislacionit, për të marrë vendime për zgjidhjen e tyre;

- Të angazhohet në evidentimin dhe licencimin e operatorëve që shërbejnë në zonat e pambuluara me shërbime ujësjellës-kanalizime të licencuara;

- Të rrisë bashkëpunimin me aktorët që operojnë në këtë sektor, me shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit, si dhe me rregullatorët analogë të huaj.

Miratuar në datën 17.7.2014